



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VORË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM Nr.11

Datë 27.02.2026

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE TE PAKETES FISKALE PËR BASHKINË
E VORËS PËR VITIN 2026**

Këshilli i Bashkisë Vorë në mbledhjen e tij të datës së 27/02/2026, bazuar në Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar ; Ligji Nr. 181/2013, datë 28.12.2013; Ligj Nr. 85/2014, date 17.07.2014; ligjit nr. 139/2015 date 17.12.2015 “Për veteqeverisjen vendore”, neni 57, germa “f”, Ligjin nr 9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrit të Financave nr 24 datë 02.09.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar;

Këshilli i Bashkisë Vorë pasi analizoi dhe shqyrtoi relacionin përkatës :

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimet e Paketës Fiskale 2026 për Bashkinë e Vorës, duke u hequr nga kategorizimi Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël për subjektet tregtare.
Tarifat vendore do të vlerësohen sipas qarkullimeve vjetore për cdo subjekt tregtar.

Për llogaritjen e Tarifave Vendore do të bazohemi në katër kategori :


- a) Subjekte me qarkullim 0-2 milion lekë
- b) Subjekte me qarkullim 2-8 milion lekë
- c) Subjekte me qarkullim mbi 8 milion lekë
- d) Subjekte VIP

Ishte :

Nr.	Kategoritë	Biznes I Vogël (me xhiro 0-2 milion lekë) lekë/vit	Biznes I Vogël (me xhiro 2-8 milion lekë) lekë/vit	Biznes I madh (me xhiro 2-8 milion lekë) lekë/vit	VIP Lekë/vit
-----	------------	--	--	---	--------------

Bëhet :

Nr.	Kategoritë	(me xhiro 0-2 milion lekë) lekë/vit	(me xhiro 2-8 milion lekë) lekë/vit	(me xhiro 2-8 milion lekë) lekë/vit	VIP Lekë/vit
-----	------------	-------------------------------------	-------------------------------------	-------------------------------------	--------------



Vlera e tarifave do të mbetet e pandryshuar.

Plani i të ardhurave për Vitin 2026 mbetet i pandryshuar.

Të gjitha ndryshimet që janë bërë do të reflektohen në tabelat përkatëse.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Vorë dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga prefektura

KRYETARE E KËSHILLIT

EMIRLANDA ÇELA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VORË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM Nr.12

Dt. 27.02.2026

**MBI MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE TË PROGRAMIT SOCIAL MBI
SUBVENCIONIMIN E QERASË PËR TË PASTREHËT NË BASHKINË VORË**

Këshilli Bashkiak Vorë i mbledhur sot më datë 27/02/2026 Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 ‘Për vetë-qeverisjen vendore’, ligjit nr.22/2018 ‘Për strehimin social’, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.459, datë 03.07.2019 ‘përcakton rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde, në kuadër të programeve të strehimit social. Këshilli Bashkiak Vorë pasi shqyrtoi dhe analioi relacionin përkatës :

VENDOSI

1. Miratimin e listës së përfituesve të programit social mbi subvencionimin e qerasë për të pastrehët në Bashkinë Vorë.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit për ndjekjen e procedurave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas shpalljes.

KRYETARE KËSHILLIT

EMIRLANDA ÇELA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VORË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM Nr.13

Datë 27/02/2026

“MBI DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z.VLADIMIR Tafa PËR SHKAK TË DJEGJES SË BANESËS”

Këshilli Bashkiak Vorë i mbledhur sot më datë 27/02/2026, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 « Për vetëqeverisjen vendore», Në zbatim të Ligjit nr.45,datë 18.07.2019, ‘Për mbrojtjen Civile’,VKM nr.329,datë 16.05.2022 ‘Për kriteret dhe procedura e dhënies së ndihmës shtetërore,financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore,kreu III ‘Procedura në rastet kur nuk shpallet gjendja e emergjencës civile’.

Në bazë të fatkeqësisë së ndodhur në datën 11.01.2026,nga rënia e zjarrit që ka ndodhur në banesën e Z.Vladimir Tafa e cila ndodhet në territorin administrativ të Bashkisë Vorë,gjithashtu bazuar dhe në proces-verbalin e përpiluar nga komisioni i ngritur me urdhër nr.6 datë 15.01.2026 nga Kryetari i Bashkisë Vorë,për të bërë verifikimin e banesës së djegur të Z.Vladimir Tafa.

Këshilli Bashkiak Vorë pasi dëgjoi dhe analizoi relacionin përkatës :

V E N D O S I

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare prej **2.054.840 lekë** për familjen e Z.Vladimir Tafa. Fondi do akordohet nga Buxheti I Bashkisë Vorë ,përkatësisht Zëri buxhetor nr.606 (Shpenzime për raste fatkeqësie).
2. Autorizohet Kryetari i Bashkisë,Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefektura.

KRYETARE E KËSHILLIT

EMIRLANDA ÇELA





1339/1

18.03.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
PREFEKTI I QARKUT TIRANË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 398/ Prot.

Tiranë më 18.3.2026

Lënda: Verifikim Ligjshmërie.

KËSHILLIT TË BASHKISË VORË

Bazuar në Ligjin nr.107/2016 «Për Prefektin e Qarkut», i ndryshuar neni 16, gërma 2/a, dhe Ligjin nr. 139/2015 « Për vetëqeverisjen Vendore», i ndryshuar, Prefekti i Qarkut Tiranë, verifikoi ligjshmërinë e vendimeve nr.8, 9, 11 dhe 13, datë 27.02.2026 të Këshillit Bashkiak Vorë.

Vendimi nr.8, datë 27.02.2026 « Mbi miratimin e buxhetit faktik 2025 »,

Konfirmohet referuar Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.

Vendimi nr.9, datë 27.02.2026 « Mbi rishikimin e buxhetit të Bashkisë Vorë për vitin 2026 »,

Konfirmohet referuar Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.

Vendimi nr.11, datë 27.02.2026 «Për miratimin e disa ndryshimeve të paketës fiskale për Bashkinë Vorë 2026»,

Konfirmohet referuar Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Vendimi nr.13, datë 27.02.2026 « Mbi dhënien e ndihmës financiare familjes së z. Vladimir Tafa për shkak të djegjes së banesës »,

Konfirmohet referuar Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012 « Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore ».

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

PREFEKTI
SHKËLQIM HAJDARI

